

VENDIM
Nr. 757, datë 16.9.2015

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 271, DATË 6.4.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR VEPRIMTARINË AKADEMIKE NË
ZBATIMIN E PROGRAMIT TË FORMIMIT FILLESTAR DHE VAZHDUES NË
SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 47, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 271, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Lejohet të aktivizohen, si ekspertë, lektorë, akademikë dhe profesorë të huaj, të cilët do të paguhën me honorarë për orë pjesëmarrjeje në procesin e mësimdhënies në Shkollën e Magjistraturës, në programin e formimit fillestar dhe atij vazhdues. Masa e pagesës nuk duhet të jetë më e madhe se 5-fishi i pagesës për orët mbi normë, për kategorinë “profesor” dhe jo më shumë se 50 orë mësimore në vit. Ekspertëve dhe lektorëve të huaj u mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, për jo më shumë se 5 ditë. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtyre pagesave, përballohen nga fondet e parashikuara për mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës”.

2. Në pikën 10, fjalët “... 0.3-0.5 orë mësimore ...” zëvendësohen me “... 0.5-1 orë mësimore ...”.

3. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1. Për miratimin e publikimeve dhe botimeve në Shkollën e Magjistraturës ngrihet Bordi i Redaktorëve, i cili është organ vendimmarrës. Bordi i Redaktorëve përbëhet nga 7 deri në 9 anëtarë, të cilët propozohen nga drejtori i Shkollës së Magjistraturës dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i saj. Anëtarët e bordit zgjidhen nga radhët e personaliteteve me tituj dhe grada shkencore, si dhe të pedagogëve me eksperiencë mbi 5vjet në Shkollën e Magjistraturës, me përjashtim të drejtorit të Shkollës, i cili është gjithmonë anëtar i bordit.”.

4. Në lidhjen nr. 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “g” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“g) Hartimi i tezave të provimit të pranimit për fazën e parë, 1 tezë, 1500 (një mijë e pesëqind) lekë dhe për fazën e dytë, 1 tezë 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë.”.

b) Pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj) Komisioni i hartimit të testit të shëndetit mendor dhe psikologjik, 1 test/20 orë mësimore.”.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara për Shkollën e Magjistraturës, brenda tavaneve të shpenzimeve buxhetore të miratuara për vitet 2015-2018.

6. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama